



MEETING MINUTES

ZBARDHJE E MINUTAVE NGA TAKIMI I ANTARËVE TË BORDIT EITI

6 KORRIK 2020

11:00 AM

ON SKYPE

LIST PREZENCA

Z. ILIR BEJTJA, **ZËVENDËSMINISTËR I MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË,
KRYETAR I GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS EITI**

Z. GENCI TËRPO, **DREJTUES I SEKRETARIATIT KOMBËTAR EITI**

ZNJ. ANILA HAJNAJ, **SHOQËRIA CIVILE**

Z.SAMI NEZA, **SHOQËRIA CIVILE**

ZNJ. OLA MITRE **SHOQËRIA CIVILE**

Z. LORENC GORDANI, **SHOQËRIA CIVILE**

Z. PËRPARIM ALIKAJ, **FIAA**

PJESËMARRËS TË TJERË

Z. LLUKA GJERGO, **SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI**

ZNJ. EMILIANA KOLA, **SEKRETARIATI KOMBËTAR EITI**

FOTO NGA TAKIMI I MSG-së



Z. ILIR BEJTJA Përshëndetje, uroj të jeni mirë...

Atëhere si rend dite kemi:

Pika e parë: Diskutim dhe vendimmarrje për Open Data Policy. Kush do të na sqarojë pak?

Z. GENCI TËRPO Mund t'ju sqaroj unë.. Siç jeni dhe ju në dijeni, EITI në Oslo ka miratuar një model për Open Data Policy i cili mund të përdoret nga pjesa e të gjithë anëtarëve që janë pjesë e EITI-it. Natyrisht çështja e Open Data Policy është diskutuar edhe më parë nga EITI, në mos gaboj në mars të vitit 2017 por duke pasur parasysh praktikën që vendet EITI kanë patur, ideja është që na kërkohet të bëjmë një miratim të Open Data Policy. Ndërkohë siç jeni në dijeni dhe ju, ne jemi duke u marrë me miratimin e termave të references për Open Data përsa i përket EITI-it në Shqipëri dhe jemi në fazën e finalizimit të tyre. Besoj që ditën e sotme ju do t'i keni me email edhe termat e referencës që do të kërkohen të miratohen nga ana juaj. Siç e dini, koha që ne kemi është shumë e shkurtër pasi grandi i Bankës Botërore vazhdon deri në fund të këtij viti dhe ne na ngelet të veprojmë shpejt në mënyrë që të jemi sa më eficientë lidhur me në përdorimin e grandit, në bërjen efektive të projekteve që ne kemi marrë parasysh. Në një ndër pikat që ne po e fillojmë është pikërisht diskutimi dhe vendimmarrja përsa i përket miratimit të Open Data Policy. Nuk e di sesa e keni parë materialin që ne ua kemi dërguar para disa ditësh.... është një material që përgjithësisht bazohet në shtyllat e standartit EITI, të cilat janë referuar vendeve anëtare EITI për t'a miratuara. Le të themi që përgjithësisht ka të bëjë me miratimin e disa parimeve të përgjithshme përsa i përket Open Data. Natyrisht edhe në projektin që ne kemi në plan të elaborojmë në javët e ardhshme, synohet pikërisht krijimi i një sistemi Open Data vetëm për Industrinë Nxjerrëse, ku baza themelore e tyre është trajtimi në mënyrë sa më i hapur i dhënave që ne kemi të pranishme në çdo vit, që lidhen përgjithësisht me raportin EITI, por paralelisht për të shtuar edhe element të tjerë që lidhen me sistemin Open Data që ka të bëjë me Industrinë Nxjerrëse. Drafti në fjalë i Open Data Policy është draft që pasyron parime të përgjithshme por të trajtuara specifikisht lidhur me

shtetin shqiptar. Nuk e di nëse keni ndonjë koment përsa i përket draftit në fjalë pasi mund t'a diskutojmë se ku mendoni se mund të shtojmë apo heqim diçka, por gjithsesi ky është një material le të themi deri diku standart, i përshtatur specifikisht për vende të caktuara EITI dhe ne jemi munduar të krijojmë një material i cili është deri diku i ngjashëm dhe pa ndryshime të mëdha nga ajo e cila është miratuar nga EITI në Oslo lidhur me përdorimin e këtij lloj standarti.

Z. ILIR BEJTJA Një pyetje: Si mund të bëhet ky i detyrueshëm?

Z. GENCI TËRPO Ne, siç ju thashë jemi duke elaboruar pikërisht projektin e Open Data që synojmë t'a zhvillojmë brenda këtyre muajve. Natyrisht ky është në një farë forme i mundshëm për t'u bërë çdo vit sepse AlbEITI çdo vit prodhon raportin EITI dhe pjesa më të madhe e të dhënave që synohen të hidhen në sistemin Open Data janë të trajtuara dhe ne do t'i kemi pothuajse çdo vit. Pra e kemi të garantuar këtë lloj materiali të cilin ne presupozohet t'a përpunojmë në një formë të tillë që të jetë në sistemin Open Data i aksesueshëm për këdo. Një situatë të ngjashme, të paktën nga kërkimet e fundit që kemi bërë e ka Gana. EITI është institucioni ynë homolog në Ganë i cili ka krijuar këto lloj sistemi, që përgjithësisht punon me të dhënat e raportit EITI dhe realisht Gana në Open Data kishte marrë dhe ata kishte marrë dhe çmimin e parë nga EITI Ndërkombëtar në vitin 2015 për sistemin Open Data. Natyrisht gjërat sa vijnë dhe zhvillohen por materiali bazë që ne do të na duhet për sistemin Open Data..... (shkëputet lidhja)

Ne mund të shtojmë gjëra të tjera të cilat lidhen me sistemin Open Data, në kuptimin e mundësive që ky lloj sistemi të krijojë, por materiali thelbësor te ne është gjithnjë i garantuar. Pra jemi ne ata të cilët e kemi në dorë që këtë lloj materiali t'a realizojmë.

Z. ILIR BEJTJA Cila është baza ligjore që këtë document do t'a bënte të aplikueshëm për të gjithë; publik ose jo public, të gjithë institucionet? Kujt i referohemi; detyrimit për informim publik?

Z. GENCI TËRPO Mund të them që i referohemi parimeve standarte që kanë të bëjnë me anëtarësimin e Shqipërisë në EITI Ndërkombëtar.

Z. ILIR BEJTJA Jo çdo gjë është e ratifikuar në legjislacionin tonë, prandaj them që mirë do të ishte që në dokument ne të bënim dhe një referencë të legjislacionit shqiptar i cili i detyron publikimin e të dhënave që të mos jetë thjeshtë i bazuar në EITI-in Ndërkombëtar dhe standartet e tyre por të shikohet dhe aspekti rregullator në vendin tonë. Përndryshe nëse ky mungon totalisht ne do të duhet t'a krijojmë por në dijeninë time, ka...

Z. LLUKA GJERGO Mund të bëj një sqarim të vogël; është ligji mineralar i cili i detyron përgjithësisht institucionet shtetërore dhe subjektet në fushën minerare dhe të naftës që të raportojnë në kuadër të Nismës EITI.

Z. ILIR BEJTJA Po, duhet ta vendosim në referencë.

Z. LLUKA GJERGO Kjo bazë ligjore ekziston, është Ligji 10304.....

Z. ILIR BEJTJA Po, unë them se ka më shumë se kaq, është ligji për detyrimin e informimit publik..... Kështu që mendimi im për dokumentat është që të ketë referencë

ZNJ. ANILA HAJNAJ Po ligji mbi EITI-in, do t'a bëjë shumë të detyrueshëm

Z. ILIR BEJTJA Po s'kemi sot ligj mbi EITI-in

Z. LORENC GORDANI Nëse mund të bëj një ndërhyrje për një sqarim të shkurtër... Atëherë, të paktën për sa më rezulton lidhur me marrëveshjet ndërkombëtare, janë direkt të zbatueshme sipas kushtetutës në kuadrin e brendshëm. Kështu që teknikisht duhet parë në qoftë se marrëveshja ndërkombëtare që ne kemi bërë me EITI-in, mund të jetë bërë nga qeveria, duhet të jetë ratifikuar në parlament nëse ka qenë që duhet të ratifikohet në parlament, kështu që merr vlerë mbiligjore dhe do të duhet të shikohet nëse është teknikisht e zbatueshme direkt apo nga ndërhyrje për adoptim të legjislacionit parësor, pra të brendshëm. Kaq kisha nga ana teknike, duhet parë.

Z. ILIR BEJTJA Unë nuk besoj se është dhe aq e vështirë... Edhe këtë mund t'a rëndisim, nëse e gjejmë ratifikimin e rregullores EITI me shtetin shqiptar që nuk besoj ka një të tillë, por edhe nëse ka, ok

Por gjithsesi të përfshihet i gjithë legjislacioni respektiv....domethënë një lloj detyrimi për transparencë, jo vetëm EITI por edhe ligji minerar dhe çdo lloj vendimi qeverie apo ligj tjetër që detyron publikimin e të dhënave në mënyrë që dhe ky dokument të marrë force ligjore, të jetë i zbatueshëm. Ndoshta pas kësaj, të paktën për sektorin, mund t'a shoqërojmë dhe me një urdhër të ministres të zbatueshëm për të gjithë stakeholders-at.

Z. PËRPARIM ALIKAJ Edhe me Ministrinë e Financave duhet parë, në qoftë se ka ndonjë gjë që përputhet me të.

Z. GENCI TËRPO Nëse mund të shtoj diçka..... Ideja është që portali Open Data nënkupton që këto janë të dhëna të cilat janë të publikuara, pra janë të dhën të cilat ne dashur pa dashur edhe po të mos ekzistojë portali Open Data i kemi të publikuara sepse po them; raporti i vitit 2016 apo 2017, 2018, në momentin që realizohet është publik. Portali Open Data nënkupton që këto lloj materialesh që ne kemi të jenë të renditura në një formë të tillë që të jenë paksa më të kuptueshme dhe më të hapura në aspektin e kuptueshmërisë për publikun. Nuk do të thotë që ne po publikojmë të dhëna që nuk janë, pra të gjitha të dhënat ekzistojnë diku. Ne mund të krijojmë një opsion të caktuar tek të dhënat që AKBN-ja publikon në mënyrë që ato të jenë të aksesueshme edhe në portalin Open Data që ne kemi. Pra nuk është se kërkohet një bazë ligjore që t'a bëjë të mundur këtë gjë sepse këto janë të publikuara, ne thjeshtë inkorporojmë pikërisht një portal të caktuar që lidhet me Industrinë Nxjerrëse. Raporti EITI është publik, ne e publikojmë por lidhur me të dhënat specifike që të jenë sa më të hapura dhe të kuptueshme më saktë për publikun dhe ne synojmë t'i vendosim në një portal të caktuar, kjo është llogjika e Open Data nuk kërkohet diçka që të ketë detyrim ligjor. Pasi detyrimi ligjor në rastin konkret është që ne kemi një projekt që është miratuar nga Banka Botërore që duhet të bëhet ky portal dhe thjeshtë realizimi dhe krijimi i këtij sistemi nënkupton që të gjitha këto të dhëna

që mund të jenë të vendosura në disa institucione ose mund të jenë të përhapura jo në formën e duhur në ëbsite-in tonë, të jenë të inkorporuara në Open Data System, të krijuar posaçërisht për të dhënë akses ne transparencë më të madhe për ata që janë në një nivel më poshtë për të kuptuar mënyrën sesi funksionon Industria Nxjerrëse.

Z. PËRPARIM ALIKAJ Më falni, kam një ndërhyrje... Këtu duhet pasur parasysh edhe problemet e kontratave që ka qeveria me investitorët dhe kompanitë e ndryshme. Duhet sqaruar mirë kjo punë, nëse do të dalin të gjithë gjërat, kontratat pasi dhe kjo me Open Data mund të jetë

Z. GENCI TËRPO Atëhere, Open Data është gjithëpërfshirëse, ka shumë element. Ne nuk synojmë që të bëjmë të mundur publikimin e çdo lloj gjëje të mundshme sepse duhet të kemi parasysh dhe një gjë pasi aq mundësi financiare kemi për të ndërtuar diçka në një version të caktuar. Duhet të kemi parasysh që portali kërkon mirëmbajtje, që do të thotë; ne paratë i kemi vetëm për realizimin brenda këtij viti dhe vitin tjetër duhet të gjejmë para të tjera për të bërë të mundur mirëmbajtjen sepse sistemi po nuk u mirëmbajt, ti nuk ke mundësi të hedhësh asnjë lloj materiali. Kjo gjë na është referuar edhe nga EITI që thotë: - ok, ju ndërtojeni në një version të caktuar fillestar, për të hedhur ato të dhëna që janë mundshme dhe të kontrollueshme nga ana juaj për t'u hedhur, në kuptimin ne po e quajmë si detyrë plus tonën që ndërtimi i portalit do të na mundësojë që këto të dhëna të vazhdojmë t'i hedhim paçka se mund të kemi ose jo ndihmë financiare. Por zgjerimi i tij në një moment tjetër lidhet detyrimisht me mundësinë financiare për t'a bërë të mundur. Pra ne po kërkojmë të ndërtojmë një sistem në qoftë se ju mund të kërkonit, një sistem të ngjashëm e ka Bashkia e Tiranës, Banka e Shqipërisë, pra janë disa institucione që e kanë këtë lloj portal Open Data dhe ata thjesht kanë punuar me të dhënat e institucioneve të tyre të cilat i vendosin në një sistem të caktuar që janë më të aksesueshme dhe më të kuptueshme për publikun, në aspektin e asaj që kërkohet. Ne mund të bëjmë një portal që të jetë i gjithëanshëm por në kushtet që ne kemi nuk mund t'a realizojmë dot sepse aq mundësi financiare kemi.

Z. ILIR BEJTJA Në kushtet që jemi, unë nuk them që ne nuk duhet t'a bëjmë, përkundrazi por tek Home, tek faqja About Us, ti do të bësh nja dy referenca që nesër të mos vijë dikush sic e tha dhe Z. Përparim, e të thotë pse i kë publikuar të dhënat e mia. Mund të thuash që ato të dhëna janë tek Tatimet, Instat-I por nuk janë marrëveshjet pra jo çdo gjë është në këto publikime. Unë nuk jam kundra, jam ok, por të merren masa ligjore që nesër të mos kemi asnjë lloj ankese. Nuk e di nëse Znj.Anila është dakort

ZNJ. ANILA HAJNAJ A mund të flas?

Z. ILIR BEJTJA Po

ZNJ. ANILA HAJNAJ Atëhere përsa u tha, është e vërtetë, unë nuk mendoj se do të jetë ndonjë vështirësi e madhe përsa i përket asaj që tha Z. Përparim. Unë kam kontakte me të gjitha bashkitë ku kam bërë monitotimin e rentës dhe më kërkojnë kontratat minerare. Kam marrë vesh që kontratat minerare janë të hapura, janë diku.... Atëhere tek portal jonë ne mund të vëmë link-un sepse njerëzit e kërkojnë në internet me emra të ndryshëm edhe mund t'i referohemi; në këtë link ju gjeni kontratat minerare të hapura. Kështu që; A është qëndra e regjistrimit? ; A është Ministria e Energjetikës? Vëmë linqet dhe njerëzit mund të kërkojnë aty dhe unë nuk besoj se ka nevojë dhe për shpenzime kjo gjë. Pse të mos bëhet.

Z. PËRPARIM ALIKAJ Mund të ketë ndonjë ankesë, klauzojë që ne nuk e dimë...

ZNJ. ANILA HAJNAJ Një pyetje; Licensat minerare a janë të hapura?

Z. PËRPARIM ALIKAJ Licensat po janë, porpara licesnat kanë ligj që kjo do të bëhet kështu, kjo do të bëhet kështu dhe duhet sqaruar pasi mund të thonë e kam sekret profesional..... Më kupton, ka gjëra që nuk duan të dalin...

ZNJ. ANILA HAJNAJ Bazuar në atë që tha Z. Lluka, në ligjin minerar, nuk duhet të jenë transparente këto gjëra?

Z. PËRPARIM ALIKAJ Patjetër, nuk ka diskutim

ZNJ. ANILA HAJNAJ Ja ku është dhe Z. Ilir, që mund të thotë që janë transparente, është baza ligjore

Z. PËRPARIM ALIKAJ Në rregull

Z. ILIR BEJTJA Patjetër që është baza ligjore.. Problemi im i vetëm, ishte ky që në disa marrëveshje ka kapituj konfidencialiteti, ka tilla, një aneks që nuk mund të publikohet dot i gjithi, ka elementë që ne nuk mund t'i publikojmë, por kjo nuk na pengon prandaj thashë; nëse ne në ëbsite do të vëmë referencë dhe pjesën e argumentit ligjor që na e jep të drejtën t'a bëjmë këtë gjë, s'ka asnjë lloj problem pasi raportet ne i nxjerrim, janë publike për të gjithë, të dhënat edhe pse të një apo dy viteve më përpara janë publike. Kështu që në këtë aspekt them që nuk kemi asnjë pengesë. Tani nuk e di për Termat e Referencës, na sqaroni diçka.

Z. GENCI TËRPO Lidhur me Termat e Referencës, ne jemi duke i përfunduar sot, duke marrë modele të ngjashme që janë përdorur qoftë në rastin konkret nga Bashkia e Tiranës, qoftë homologët tanë nëpër vende të ndryshme për të krijuar një version fillestar i cili krijon mundësinë për të vendosur me kalimin e kohës edhe informacionet e tjera. Por e rëndësishme është pasja e një portali që të paktën minimalisht ose maksimalisht me të dhënat që ne disponojmë apo të dhëna të cilat janë bërë publike, po marr rastin e konkret Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, çdo gjë që lidhet me Industrinë Nxjerrëse, AKBN-në apo Doganat, Tatimet, këto lloj informacionesh të jenë deri diku të inkorporuara dhe të përqëndruara në sistemin Open Data që ne synojmë të krijojmë. Pikësëpari, kjo është një punë që lidhet më tepër me ekspertizën në fushën e It-së, pra krijimi i një sistemi të tillë e kërkon një ekspertizë në këtë fushë për t'a inkorporuar në formën që ne duam. Natyrisht, ky portal do të ketë nevojë edhe për të shtuar informacione dhe ne do t'a krijojmë në formë të tillë që mundësia për të shtuar informacionet, të jetë active. Por kjo është për t'u elaboruar kohë pas kohe e gjithë kjo procedurë e cila do të sjellë krijimin e një sistemi sa më të fuqishëm që krijon Open Data në fushën e Industrisë Nxjerrëse. Pra e thënë ndryshe ne po synojmë të krijojmë një version i cili është në fazën mbi fillestaren.

Ju mund t'i referoheni përshembull është një portal opendata.al që është bërë me investimin e Ambasadës Amerikane, në mos gaboj dhe ata kanë krijuar një sistem Open Data për këdo, që do të thotë tek ky lloj sistemi ti mjafton të hysh dhe mund të gjesh informacione deri diku për çdo person që mund të ketë një biznes ose për kontrata të caktuara. Pra këto lloj informacionesh, opendata.al i ka por në mënyrë të përgjithshme. Ne kërkojmë të bëjmë diçka të ngjashme, pra ju duhet ndoshta dhe t'a shihni. Të ngjashme, që lidhet pikërisht me Industrinë Nxjerrëse e që krijon akses për këdo që është i interesuar të marrë informacione. Nga ana tjetër, po t'u referohemi sistemeve Open Data që kanë bërë institucionet e ndryshme në Republikën e Shqipërisë, Open Data ka arritur në një pikë të fillë që gjithnjë ka publikuar informacione të cilat i përkasin një viti më përpara. Pra zakonisht informacionet nuk janë të ditës së sotme por janë informacione të një viti më përpara, mund t'i referohemi Bashkisë së Tiranës. Pra ne kemi parë disa sisteme të cilat kanë krijuar një version të mirë të sistemit Open Data. Ne do të bëjmë pikësëpari krijimin e modelit të Open Data-ve dhe do të krijojmë të gjitha akseset e nevojshme ose më saktë vendosjen e hapësirave të nevojshme për t'a pasqyruar tek sistemi në vijim por materialin bazë i cili do të jetë thelbësor në sistemin Open Data ne e kemi pasi ne bëjmë raportin EITI dhe ketu materiali thjesht punohet dhe vendoset në një formë sa më të kuptueshme për publikun.

ZNJ. ANILA HAJNAJ Ky ligji mbi informimin deri në çfarë kufiri informacioni mund të ofrohet sepse në bazë të ligjit për informimin, nëse unë kërkoj informacion për X kompani të Industrisë Nxjerrëse dhe janë të detyruar të më japin informacion, Znj. Ola madje është më e informuar për këtë. Kështu që ne do të vendosim atë kufi që na lejon ligji për të drejtën e informacionit, maksimumin e asaj edhe unë jam shumë e bindur që kjo do t'u shërbejë më shumë bashkive sesa njerëzve. Domethënë do t'u hyjë në punë institucioneve sepse ata s'po gjejnë informacione për vete.

ZNJ. OLA MITRE Edhe diçka tjetër, në lidhje me vjetërsinë e të dhënave, jo gjithmonë janë të dhëna të para një viti. Kështu që të dhënat e para një viti nuk

janë shumë të vlefshme edhe ne e kemi thënë këtë edhe për raportin EITI që janë shumë të vjetra. Të paktën opinionit publik, medias shumë pak mund t'i hyjnë në punë pasi janë të dhëna që nuk i shërbejnë askujt. Prandaj ne duhet të fusim elementë përshembull për të dhëna që vijnë nga institucionet shtetërore të cilat mund të menaxhohen lehtësisht nga ana jonë, siç është AKBN-ja përshembull, që të jenë të dhëna të cilat update-ohen me këtë system. Nuk ka pse të jenë të dhëna që vetëm dalin pas përfundimeve. Mund të jenë të dhëna që raportohen pranë AKBN-së që nuk mund të jenë aspak sekret shtetëror dhe s'ka pse të mos jenë pjesë e këtij portal që ne synojmë të ngrejme.

Z. GENCI TËRPO Atëhere, ne do të hedhim çdo lloj të dhëne që lidhet me Industrinë Nxjerrëse që në rastin konkret, publikohet nga institucionet kompetente. Por duhet të kuptojmë një gjë; që ky lloj sistemi do të fillojë me një bazë dhe baza që ne përgjithësisht kemi dhe e kemi tonën janë raportet EITI. Siç e dini raportet EITI kanë një afat 2-vjeçar pra në vitin 2021 bëhet raporti i 2019-tës tek pjesa e punës sonë. Megjithatë kjo nuk përbën ndonjë problem, ne po synojmë të bëjmë një Open Data me të dhëna që disponojmë dhe nga ana tjetër me të dhëna që publikohen nga çdo lloj agjensie shtetërore ku duke specifikuar në secilin informacion që ky lloj informacioni është marrë nga ky lloj institucioni dhe besueshmëria e tij lidhet me punën që ka bërë institucioni në fjalë. Por qëllimi i Open Data është pikërisht të ndërtojmë një sistem i cili do të ketë informacione të grupuara dhe të specifikuara për çështje të caktuara. Natyrisht kjo është një punë e gjerë, me kalimin e kohës do të ketë nevojë dhe për shtimin e titrave të tjera në këtë lloj sistemi por ne po mundohemi t'a realizojmë njëherë, më pas shtimi i elementëve të tjerë është një që realizohet me kalimin e kohës. Pra nuk mund të bëjmë një sistem të jashtëzakonshëm që të përfshijë çdo lloj të dhëne pasi këto janë të dhëna të cilat ne nuk i marrim pasi janë të fshehura diku por janë të dhëna që ne i inkorporojmë pasi janë të publikuara. Kështu ne nuk çënojmë informacionin pasi këto të dhëna janë të publikuara, ky është qëllimi.

ZNJ. OLA MITRE Genci, Jo gjithmonë informacionet që janë, janë të publikuara pasi institucionet këtu prodhojnë shumë të dhëna dhe i mbajnë vetëm për veten e tyre, nuk i publikojnë. Ligji për të drejtën e informimit e ka që për informacione që nuk përbëjnë sekret ose që nuk janë konfidenciale, duhet të publikohen automatikisht, kjo gjë nuk ndodh me institucionet, prandaj duhet që në këtë portal të ketë diçka ndryshe dhe jot ë ketë të dhëna që nuk i shërbejnë askujt. Duhet të kuptohet ky konektiviteti me institucionet e tjera që të dhënat që prodhohen dhe ata i kanë por që kanë tendencën t'i fshehin gjithmonë, duhet të jenë publike.

Z. GENCI TËRPO Unë jam shumë dakort me atë që thua ti që të dhënat të cilat kanë detyrimin për t'u publikuar, të publikohen por e para që ne duhet të bëjmë është krijimi i një sistemi pasi mospatja e një sistemi nuk na jep mundësinë për të shkuar më tej.

ZNJ. OLA MITRE Pasja e një sistemi por edhe nga ana tjetër dhe të update-ohet pra kompania që të ketë këtë sistem të ketë dhe detyrimin që t'i të update-ojë të dhënat

Z. GENCI TËRPO Po, patjetër

Sigurisht dhe mirëmbajtja është element. Ka dhe diçka tjetër që ne mundësinë financiare për t'a bërë këtë gjë e kemi deri në dhjetor, që do të thotë që nëse nuk e bëjmë këtë gjë, nuk bëhet pasi kemi dhe 6 muaj kohë.

ZNJ. ANILA HAJNAJ Një pyetje; Ky sistemi është një website?

Z. GENCI TËRPO Le të themi që është një model i përparuar që inkorporohet brenda një website..... është një program, le t'a quajmë program

Z. ILIR BEJTJA Mund të bëj një pyetje për Termat e Referencës pasi ne themi: pika dy - Vendimmarrje për Terms of Reference; Ku i kemi Termat e Referencës?

Z. GENCI TËRPO Termat e Referencës, siç ju thashë do t'jua paraqesim sot

Z. ILIR BEJTJA Atëhere do t'i miratojmë online dhe....

Me qenë se unë, siç ju thashë jam i mbivendosur, kalojmë tek pika katër dhe pastaj pikën tre mund t'a diskutoni nën drejtimin e Znj. Hajnaj. Pika katër – Vendimmarrje për rishikimin e Planit të Punës për vitin 2020. Cila është aryeja që duhet t'a rishikojmë?

Z. GENCI TËRPO Pas komunikimit të fundit që kemi patur me EITI në Oslo dhe në mos gaboj ju kemi dërguar edhe emailin që ata na përcjellin ne ku synojnë që MSG duhet të bëjë një ndryshim të planit të punës për disa elementë të caktuar. Nuk e di nëse e keni parë emailin që ju është bashkangjitur.

Z. ILIR BEJTJA Për të thënë të vërtetën, nuk e kam parë por ju lutem të na bëni një përmbledhje të shkurtër.

Z. GENCI TËRPO ...Shkëputet linja

Z. ILIR BEJTJA Ju lutem, unë jam dakort me pjesën tjetër dhe ta vazhdojë znj. Hajnaj drejtimin e mbledhjes pasi më duhet të shkëputem për një mbledhje tjetër me Sekretariatit e Energjisë. Ju kërkoj ndjesë!

Z. Tërpo ka shkëputje të lidhjes së internetit

Z. GENCI TËRPO Ju lutem më dëgjoni? Atëhere në emailin e datës 02/07/2020 Sekretariati Oslo specifikon që nga ana e MSG-së duhet të konsiderohen disa element duke ju referuar kërkesës 1.5, te Plani i Punës duhet të specifikoj hapjen e çështjeve të kontratave dhe atë çka ne diskutuam lidhur me minierat në fushën e industrisë nxjerrëse dhe deadline-t të specifikuara lidhur me këtë çështje. Gjithashtu MSG-ja duhet të specifikoj progresin e vëndit lidhur me kërkesat e specifikuara në pikën 2.4 dhe të sygjeroj hapat e tjerë lidhur me Planin e Punës. Plani i Punës duhet të reflektoj sipas EITI dhe të trajtohet edhe nga MSG, transparencën në fushën e kontratave, kontraktorëve, liçensave, çdo gjë që ju është dhënë atyre. Kjo gjë duhet të jetë e detyrueshme nga 1 Janari i vitit 2021. Gjithashtu ata kanë dërguar edhe një checklist për një plan të integruar lidhur me transparencën në fushën e kontratave. Nga ana tjetër duke ju referuar kërkesave të pikës 1.5 MSG-ja duhet të adresoj hapa të tjerë lidhur

me transparencën në fushën e implementimit të standarteve EITI lidhur me kompanitë dhe sistemet qeveritare. Gjithashtu sipas EITI në Oslo MSG-ja duhet të adresoj qëllimet e implementimit duke përfshirë plane për forcimin sistematik të hapjes së këtyre të dhënave dhe adresimin e elementëve teknik lidhur me raportimin. Pra me pak fjalë kjo është çfarë na është sygjyeruar nga EITI lidhur me Planin e Punës. Ne këtë takim të sotëm e kemi në fushën e një diskutimi lidhur me atë çfarë kërkohet për ti bërë ndoshta një update-im planit të punës. Qëllimi jonë është të bëjmë një update-im të planit të punës sipas kërkesave rekomandimeve që EITI Oslo ka pasqyruar dhe ne mund t'ja përcjellim edhe njëherë në një mbledhje tjetër që ju ta rishikoni por po të shihet ajo që është transferuar prej tyre i referohet termave të përgjithshme, nuk është se fokusohen te një pikë e caktuar e planit të punës. Flitet në përgjithësi me hapat e tjerë që duhet të ndërmarë MSG-ja për sa i përket çështjes së transparencës apo publikimit të kontratave apo sistemeve të hapjes së të dhënave. Pra ky është një diskutim i vazhdueshëm- on going sepse siç ju thashë duhet të kemi parasysh pjesën që ne jemi në një limit kohe të jashtëzakonshme, koha është një luks që ne nuk e kemi. Banka Botërore na ka financuar për të bërë këto projekte deri në dhjetor të këtij viti. Dhjetori është deadline-i ku të gjitha projektet që ne kemi duhet të kenë marrë produktin e nevojshëm në mënyrë që të jemi korrekt me donatorët nga njëra anë por të jemi korrekt edhe me pjesën e respektimit të standarteve EITI, që pikërisht EITI në Oslo pore dhe ne si vend anëtarë kemi detyrimin për të realizuar. Duhet të më mirëkuptoni tek një pjesë që kur jua dërgojmë Termat e Referencës dhe ndoshta ju kërkojmë që të rishikohen pak më shpejt seç duhet por e bëjmë këtë gjë sepse nuk kemi kohë. Që do të thotë ndërtimi i një portali do minimalisht tre muaj ose katër muaj. Vetëm procedurat e prokurimit që bëhen duan një muaj e gjysëm dhe po ti referohesh kohës ne jemi në limitet e kohës për ta bërë këtë gjë në një kohë të shkurtër në të kundërt kjo gjë nuk bëhet. Prandaj ne jua çojmë me një kërkesë pak më të shpejtë që ju t'i shihni. Kjo është llogjika e kësaj që në një fare forme unë jua kam transmetuar edhe përpara në mënyrë individuale me të gjithë ju, që tju them të drejtën keni qënë shumë dashamirës për sa i përket pjesës për të na ndihmuar. Por kjo është

ndonjëherë ngutja që ne kemi, që shtroi dhe Znj. Mitre që sa kohë kemi. Ju keni të gjithë kohën e nevojshme që do të thotë ju mund ti miratoni edhe për një javë pore dhe për dy muaj por për dy muaj ne nuk na hyn më në punë për të kryer të gjitha këto sepse nuk bëhen. Prandaj kërkohet një kohë sa më të shkurtër që ju të reflektoni ku edhe ne të jemi korrekt me ju pore dhe me ata që supozohet të na financojnë lidhur me këto që ne duam të bëjmë. Pra lidhur me rishikimin e Planit të Punës mendoni që duhet ta rishikojmë sipas kërkesave të EITI-it në Oslo apo duhet të vazhdojmë me Planin e Punës që ne kemi?

ZNJ. ANILA HAJNAJ Unë mendoj që tre pika nga ato që kërkohen nga Oslo ishte që do të realizohen me Open Data, nëse nuk gabohem?

Z. GENCI TËRPO Po

ZNJ. ANILA HAJNAJ Kështu që kjo i bie që të realizohet. Rishikimi i Planit të Punës do të thotë që neve të kufizohemi dhe të përqëndrohemi tek kjo dhe të lëmë disa programe të tjera dhe buxhetin t'ja kalojmë këtyre apo si mendoni?

Z. GENCI TËRPO Jo, ne të gjitha aktivitetet e tjera do ti vazhdojmë pa diskutim.

ZNJ. ANILA HAJNAJ Dakort!

Z. GENCI TËRPO Kjo është një pikë e Planit të Punës që ne e kemi miratuar në fillim të vitit. Por rishikimi për mendimin tim, në rastin konkret do të fillojë të realizohet dhe duhet të realizohet në momentin që ne e kemi vënë në vijë dhe ka njerëz që po punojnë dhe po merren me këtë gjë. Ne sot jemi akoma në fazën që përgatim Termat e Referencës dhe jua përcjellim. Në momentin që përfundojnë të gjitha procedurat mendoj që kjo gjë, mund të ndodhi nga muaj shtator sepse procedurat kërkojnë një fare kohe. Dhe nga shtatori ne mund ti bëjmë një rishikim planit të punës në përputhje edhe me atë çka ne kemi vënë konkretisht në proces ecje sa i përket projekteve dhe në një fare mënyre ne jemi në rregull edhe me atë ç'ka EITI në Oslo rekomandon për të rishikuar të planin e punës.

ZNJ. ANILA HAJNAJ Nëqoftëse tek pika ku duhet të hapen kontratat, ne dimë që Ministria e Energjitikës i ka të gjitha kontratat në website të saj. Ne mund të marrim këtë iniciativë dhe të jetë vendim i MSG-së që në eëbsite që ne kemi si EITI të vendoset linku i Ministrisë dhe ku të jetë jetë evidente që në këtë link kushdo gjen të gjitha kontratat. Besoj kjo është shumë e thjeshtë.

Z. GENCI TËRPO Dakort

ZNJ. ANILA HAJNAJ Dhe për pikën tjetër të vendoset, pasqyrohet në website-in tonë linku nga Ministria e Financave pasi kjo Ministri boton çdo muaj sesa rentë është mbledhur.

Z. GENCI TËRPO Ky diskutim që ne po bëjmë na ndihmon për të shtuar element të tjerë të termat e referencës që synojmë tju nisim sot dhe në ditën në vijim Ju ti miratoni.

ZNJ. ANILA HAJNAJ Ju lutem për pikën tjetër, mund të propozoj një gjë ku secili nga ne të japi ide se si mund të hapet ky informacioni dhe më pas të bihem dakort. Pasi secili nga ne mund të ketë ide shumë të mira ku përshembull Z. Alikaj pasi ai është më së miri i azhornuar me kompanitë, se çfarë të dhënash mund të marrim ne nga eëbsite-et e tyre. Pra secili nga ne të japi indikacione se ku mund të merret informacioni për të pasur transparencë sa më të madhe dhe këto të publikohen në eëbsite e EITI-it.

Z. GENCI TËRPO Atëhere që ju të mos lodheni shumë pikë së pari merreni një herë termat e references që ne do të paraqesim sot. Gjithnjë termat e references janë në përputhje me atë çka është pasqyruar edhe nga EITI në Oslo duke ju referuar modelit stadnart që ata kanë. Në mënyrë të ngjashme ne kemi përdorur edhe praktikën që ka patur Banka Botërore në vënde të ndryshme të botës lidhur me sistemin Open Data. Gjithnjë duhet të kuptojmë që sistemi Open Data është një sistem software, i padukshëm për atë ç'ka ekziston në aspektin e prekjës. Ky sistem gjithë kohës do të jetë i laburuar, aktivë për sa i përket elementëve shtesë që ne do të specifikojmë. Më saktë unë do kërkoja që ju të shikonit sistemin open data që ka Gana ku mund ta gjeni në faqen EITI të Ganës

dhe në opinionin tim mendoj se ishte një sistem i mirë. Gjithsesi ka element të tjerë dhe vënde të tjera që ju mund të shikoni. Ne do ta shtojmë me kalimin e kohës por në kushtet që ne kemi aktualisht, duke pasur parasysh që kemi një kohë shumë të shkurtër, ku koha e shkurtër nënkupton ndërtimin e sistemit dhe hedhjen e të dhënave që ne kemi si fazë fillestare. Ky sistem me kalimin e kohës do të kërkoj mirëmbajtje, do të kërkojë shtimin e elementëve të tjerë. Ne po themi duam të ndërtojmë produktin fillestar. Se sistemi open data do të thotë të fillojmë që nga viti 1990 dhe të publikojmë çdo lloj të dhëne ose më saktë nga cili vit do fillojmë të publikojmë nga viti 1990 apo nga viti 2012 ku ne kemi filluar me Standartin EITI sepse ka të bëjë shumë edhe kjo pjesë, nga ku do të filloj elementi i Open Data sepse Open Data nuk do të thotë të ketë vetëm informacione vetëm për vitin ku ne jemi por open data do të thotë që ka informacione për një rrjedhë të gjatë kohore. Pra ne po synojmë të ndërtojmë një sistem. Sistemi të ekzistoj dhe elaburimi me kalimin e kohës do të thotë që aty të ketë për të shtuar edhe gjëra të tjera. Sepse nuk mund të hedhim çdo gjë që ekziston sepse nuk ekziston mundësia të hedhim çdo gjë që ekziston por ne do krijojmë opsione që këto lloj të dhënash të jenë të krijuara që sistemi të punoj me kalimin e kohës, elaburohet me kalimin e kohës për të qënë sa më adapt dhe sa më i plotë.

ZNJ. ANILA HAJNAJ Shumë mirë Genci.... (lidhja ka shkeputje) E rëndësishme është të fillohet baza sepse ... Edhe diçka tjetër, ëeb-site i Sekretariatit është problematik.

Z. GENCI TËRPO Lidhur me ëeb-site ne jemi duke punuar për të bërë përmirësimin e faqes web të EITI-it Shqipëri. Besoj që brënda korrikun ne do mundohemi të kemi një website të ri dhe shumë më të plohtë dhe më të lehtë për tu aksesuar nga kushdo. Realisht ka filluar puna dhe besoj fundi korrikut do të na gjej me një faqe të re.

ZNJ. ANILA HAJNAJ Dhe një sygjërim që më është bërë nga Validuesit, do ju lutesha te faqja e website-it të hiqet emërtimi Sekretariati por të vendoset EITI

Shqiptar. Ky është një sygjërim i Validuesve ku më thanë që MSG është më e rëndësishme se Sekretariati. Pra MSG e para.

Z. GENCI TËRPO Do ta pasqyrojmë në formën më të mirë të mundshme edhe këtë element pasi janë gjëra teknike dhe mund të realizohen.

ZNJ. ANILA HAJNAJ Meqënëse mua mu bë vërejtje nga ata ta keni edhe juve parasysh.

Z. LORENC GORDANI Ju lutem mund të shtoj diçka. Unë besoj që në finale do arrihet ...por ajo që kam fituar me eksperiencën time, ku që në fillim problem është që ndërtohet një platformë dhe ajo nuk update-ohet më. Kështu që unë besoj se ne duhet që në fillim, sepse e diskutuam që plani do jetë deri në fund të vitit por që në fillim duhet të bëjmë bazën, sepse nuk e dëgjova dhe nëse se kam kuptuar ju kërkoj ndjesë, që nuk do ketë një person që do të jetë përgjegjës. Sipas meje kryesore është personi që do të merret me këtë sepse me këtë mënyrën tonë të të punuarit natyrisht do ketë atë fillimin e vetë dhe më pas do humbasë, do të tretet. Kështu që unë besoj se do të duhet një person, ndoshta dhe diçka e tillë duhet të studiohet edhe se si funksionojnë websitet e tjera, si open data Albania që u përmend, etj. Dhe një specifikë tjetër që mund të shtohet është edhe eksperiencia që mund të merret nga QKB-ja. QKB-ja lidhur pikërisht me këtë që na shkon neve, liçensat, lejet minerare, dhe të gjitha ato çfarë kërkohen nga kontratat konçesionare etj. Pra ka tre kategori, ka kategorinë e atyre që mjafton paraqitja e kërkesës, ka dhe kategorinë e dokumentave shoqëruese ka dhe kategorinë e tretë ku hyn në mënyrë direkte duke hedhur të dhënat...sipas përcaktimeve që kërkon ligji. Pra unë nuk po them që ne ti ezaurojmë të gjitha për sa do jetë kohë zgjatja por që në fillim të planifikohet në këtë drejtim sepse nuk mungojnë të dhënat por duhet përpunimi dhe ajo që kam parë te materiali, thuhet që materialet të jetë i kuptueshëm, të thjeshta, të përdorshme etj. Pra do të thotë që dikush duhet të ketë ekperiencë të vazhdueshme dhe të jetë dhe përgjegjës ku të na thotë çfarë ka ngecur, çfarë jo, domethënë të ketë një koordinator. Këto ishin të përmbledhura dhe që mendoja të thoja.

Z. GENCI TËRPO Një nga elementët që ju paraqitët, pikërisht elementi parë është te pjesa e termave të referencës të sistemit të open data. Pra trajnimi i personave që do të merren me open data brënda në Institucionin EITI është një nga pikat që e kemi specifikuar. Mirëmbatja më pas, sepse ju të gjithë e dini që ne jemi të detyruar të kërkojmë donacione për hapat e mëtejshëm apo për projektet e mëtejshme.(Shkëputet linja)

Z. GENCI TËRPO Ju kërkoj ndjesë por mu fik telefoni.

ZNJ. ANILA HAJNAJ Genci, që mos ta zgjasim këtë pikë më, se ju na i sqaruat disa herë, dërgoni Termat e Referencës dhe secili nga na të bëj sygjerimet e duhura.

Z. GENCI TËRPO Dakort!

ZNJ. ANILA HAJNAJ Pika tjetër, diskutimi i rekomandimeve e Sekretariatit Ndërkombëtar për përfundimin e Raportit EITI 2017-2018, të elementëve që do të shërbejnë ...që implementimi i EITI është duke kontribuar në mënyrë të sigurt në përpjekjet që janë bërë në nivel lokal dhe kombëtar në përgjigje të pandemisë COVID19. Kemi ndonjë ide për këtë.

Z. GENCI TËRPO Ne i kemi kërkuar Bordit EITI para një muaji një kërkesë për shtyrjen e afatit të dorëzimit të Raportit EITI për vitin 2017-2018 dhe paralelisht një shtyrje për afatin e validimit për një periudhë 6 mujore. Nga bisedat që kemi bërë me përfaqësuesit e Bordit EITI në Oslo ata përgjithësisht kanë operuar duke i shtyrë këto lloj afatesh për shkak të pandemisë të virusit korona i cili është present në të gjitha vëndet e botës. Nga ana tjetër, vetë Bordi i EITI në Oslo kanë miratuar disa element të cilat ne jua kemi nisur lidhur me mënyrën e raportimit për sa i përket Raportit EITI. Le ti quajmë ca raportime deri diku më të kufizuara, të lidhura me çështjen e pandemisë. Prandaj e kanë çmuar që të gjitha vendet që janë pjesë e Standartit EITI duke pasur parasysh që kanë patur probleme lidhur me virusin korona, kanë pasur vështirësi dhe në aspektin e raportimit. Dhe ata kanë miratuar dhe trajtuar disa elementë që mund të përdoren për të mos ndaluar çështjen e raportimit në kohë dhe për tu mos

shtyrë por për të gjetur mes këtyre elementëve si një nga format e mundshme të raportimit. Sot ne e kemi trajtuar vetëm në elementin e diskutimit, juve mund ti referoheni më thellë tek emaili që ne ju kemi çuar lidhur me atë çka sygjeron EITI. Unë jam i mendimit përse kohë që ne e kemi bërë një kërkesë për shtyrjen e afatit, qoftë në aspektin e dorëzimit të raportit EITI, qoftë në aspektin për Validimin, Bordi EITI ka për ta trajtuar këtë çështje shumë shpejt, ne mund ti qëndrojmë formës standarte të raportimit pa krijuar modele të reja qoftë edhe për shkak të pandemisë. Pra ne mund të vazhdojmë me të njëjtën formë raportimi siç kemi bërë, mjafton Bordi EITI të na e shtyj afatin dhe unë besoj se do të na e shtyj. Ata kanë sjellë thjesht modele shtesë ku thonë që mund të përdorni edhe këtë lloj modeli raportimi përshkak të situates së pandemisë. Gjithësesi ju mund ta shikoni dhe e ridiskutojmë nëse mendoni që mund të përdorim ndonjë nga modelet që ju do e çmoni më shumë.

Z. PËRPARIM ALIKAJ Na sillni materialet siç e lamë, ti shohim më në detaje dhe të japim dhe ne aprovimin tonë. ...në parim jam dakort nuk kam as një kundërshtim dhe të shohim çfarë na përshtatet ne nga ato rekomandime.

Z. ANILA HAJNAJ Ndonjë ide tjetër? Atëhere mendoj se u ezauruan të gjitha dhebesoj të gjithë do të impenjohemi për të dhënë përgjigje sa më shpejt.....

Mbyllet mbledhja 00:59:51'

